

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

Gjykata Supreme e Kosovës
Ap.-Kz. Nr. 467/2011
Prishtinë
03 prill 2012

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Supreme e Kosovës ka mbajtur seancën e kolegjit sipas nenit 26 paragrafi (1) të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së) dhe nenit 15.4 të Ligjit mbi kompetencat, përzgjedhjen e lëndëve dhe caktimin e lëndëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (LmK) më 24 nëntor 2009 në ndërtesën e Gjykatës Supreme në kolegjin e përbërë prej gjyqtarit të EULEX-it Gerrit-Marc Sprenger si kryetar i kolegjit dhe gjyqtarëve të Kosovës Marije Ademi dhe Salih Toplica si anëtarë të kolegjit

Me Znj. Mia Mezini si procesmbajtëse,

Në prani të

Prokurores së shtetit Znj. Laura Pula, Zyra e Prokurorit të Shtetit të Kosovës (ZPShK)

Avokatit mbrojtës D.R. për të pandehurin A. A.

Avokati mbrojtës R.G. për të pandehurën V. F.,

Në lëndën penale me numër AP.-KZ. Nr. 467/2011 kundër të pandehurve:

A. A., i lindur më XXX në XXX, shqiptar i Kosovës, me vendbanim në Prishtinë, rruga XX, emri i babait XXX, mbiemri i vajzërisë së nënës XXX, i martuar, baba i katër fëmijëve, me gjendje ekonomike mesatare, i padënuar më parë;

V. F., e lindur më XXX në XXX, shqiptare e Kosovës, me vendbanim në Prishtinë, XX, emri i babait XXX, mbiemri i vajzërisë së nënës XXX, e pamartuar, me gjendje ekonomike mesatare, nuk është duke u zhvilluar procedurë;

Në pajtim me aktgjykimin e shkallës së parë Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në lëndën P. Nr. 44/09 të datës 07 korrik 2011 të regjistruar në shkrimoren e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë në të njëjtën ditë, **dy të pandehurit janë shpallur të pafajshëm për veprat penale në vijim:**

A. A.

Për kryerjen e veprës penale **Shpërdorim i pozitës zyrtare apo autorizimit**, sipas nenit 339 paragrafit 1 të Kodit Penal të Kosovës (KPK-së) në dy lëndë (sipas pikave 2 dhe 3 të aktakuzës së konfirmuar);

V. F.

Për kryerjen e veprës penale **Shpërdorim i pozitës zyrtare apo autorizimit**, sipas nenit 339 paragrafit 2 në lidhje me paragrafin 1 të KPK-së (sipas pikës 2 të aktakuzës së konfirmuar).

Gjatë fjalës përfundimtare, Prokurori Publik ka tërhequr aktakuzën lidhur me pikat 4 dhe 5 për **Shpërdorimin e pozitës zyrtare ose autorizimit**, sipas nenit 339 paragrafit 1 të KPK-së kundër të pandehurit A. A., kjo e fundit është pranuar nga Gjykata e Qarkut me rezultatin se të dy pikat janë refuzuar sipas nenit 389 paragrafit 1 të KPK-së.

Prokurori Publik i Qarkut ka paraqitur ankesë më 29 prill 2011 kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, duke pretenduar në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje të ligjit penal. Është propozuar që të ndryshohet aktgjykimi i shkallës së parë dhe të zëvendësohet lirimi i dy të pandehurve me shpalljen fajtorë siç ka qenë qëllimi i aktakuzës, duke iu shqiptuar dënimet e duhura, ose të anulohet aktgjykimi i kundërshtuar dhe lënda të kthehet në shkallën e parë për rigjykim.

Avokatët mbrojtës të të dy të pandehurve janë përgjigjur në ankesën e Prokurorit Publik të Qarkut në Prishtinë, mbrojtja e A. A.T më 08 shtator 2011 dhe mbrojtja e V. F. më 12 shtator 2011. Të dy avokatët mbrojtës kanë theksuar se vërtetimin i fakteve i bërë nga Gjykata e Qarkut ka qenë i drejtë dhe kanë propozuar që të refuzohet ankesa e Prokurorit Publik si e pabazuar.

ZPShK-ja, me përgjigjen e datës 16 dhjetor 2011 plotësisht ka mbështetur ankesat e paraqitura nga Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë dhe ka propozuar aprovimin e ankesave.

Në bazë të aktgjykimit me shkrim në lëndën P, Nr. 44/09 të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë të datës 16 dhjetor 2011 (e paraqitur në shkrimoren e gjykatës në të njëjtën ditë), ankesat e dorëzuara me shkrim nga Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë, përgjigjet në ankesa të paraqitura nga avokatët mbrojtës të dy të pandehurve, mendimin e ZPShK-së, dosjet relevante dhe parashtrësit me shkrim të palëve gjatë shqyrtimit më 03 prill 2012, së bashku me analizën e ligjit të aplikueshëm, Gjykata Supreme e Kosovës pas këshillimit më 03 prill 2012, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

Ankesa e Prokurorit të Gjykatës së Qarkut REFUZOHE T SI E PABAZË. Aktgjykimi P. Nr. 44 / 2009 i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, i datës 7 korrik 2011 VËRTETOHE T.

A R S Y E T I M

HISTORIA PROCEDURALE

Më 23 janar 2009, Prokurori publik i qarkut të Prishtinës ka ngritur Aktakuzën kundër të pandehurve A. A. dhe V. F., duke e akuzuar A. A. për vepra të shumta penale të **shpërdorimit të pozitës zyrtare ose të autorizimit**, sipas nenit 339, par. 3, lidhur me par. 1 dhe par. 1 të KPK-së gjatë periudhës kohore prej vitit 2006 deri në vitin 2008, duke e akuzuar V. F. me vepra të shumta penale të **shpërdorimit të pozitës zyrtare ose të autorizimit**, sipas nenit 339, par. 2, lidhur me par. 1 dhe par. 1 të KPK-së gjatë periudhës kohore prej vitit 2004 deri në vitin 2006. Këto pohime të aktakuzës janë të ndara dhe të pavarura për secilin të pandehur dhe nuk pretendohet se këta dy të pandehur kanë vepruar si bashkëkryerës.

Sipas pretendimeve të aktakuzës, i pandehuri A. A. ka qenë person zyrtar i punësuar në Aeroportin ndërkombëtar të Prishtinës, i cili në këtë cilësi dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm material për vete apo për persona të tjerë ka shpërdorur pozitën e vet zyrtare ose autorizimin në pesë raste të ndara.

Pika 1 e aktakuzës pohon se A. A. ka shpërdorur pozitën e vet zyrtare ose autorizimin gjatë shtruarjes dhe mirëmbajtjes së një piste të aeroportit, duke keqpërdorur në këtë rast burimet financiare të aeroportit.

Sipas pikave 2, 3, 4 dhe 5 të aktakuzës, A. A. pretendohet se ka shpërdorur detyrën e vet zyrtare ose autorizimin për shkak të punësimit dhe avancimit të disa punonjësve të aeroportit, në veçanti të M.K. (pika 2), N.G. (pika 3), B.Z. (pika 4) dhe V.G. (pika 5).

Sipas pretendimeve të aktakuzës, e pandehura V. F. ka qenë person zyrtar e punësuar në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, e cila në këtë cilësi dhe me qëllim të përfitimit material për veten ose për të tjerët ka shpërdorur pozitën ose autorizimin e vet zyrtar në dy raste të ndara.

Sipas pikës 1, V. F. pretendohet se ka tejkalluar autorizimet e saja profesionale lidhur me një tender për ndërtimin e rrethojës së aeroportit. Në veçanti, kjo e pandehur nuk ia kishte dhënë kontratën ofertuesit më të lirë, duke e dëmtuar kështu aeroportin në shumën prej 31,229.00 €.

Sipas pikës 2 të aktakuzës, e pandehura V. F. nuk kishte ushtruar detyrën e vet profesionale lidhur me pagesën e karburanteve për aeroportin, duke e dëmtuar kështu aeroportin në shumën prej afërsisht 3,145.00 €.

Seanca dëgjimore është mbajtur më 13 tetor 2010, e cila kishte rezultuar me hedhjen poshtë të pikës 1 të aktakuzës ndaj të pandehurit A. A. si dhe të të gjitha pikave të aktakuzës ndaj të pandehurës V. F., përderisa aktakuza në fjalë ishte konfirmuar në pjesët tjera.

Pas paraqitjes me kohë të ankesës së Prokurorit publik të Prishtinës, lidhur me hedhjen poshtë të akuzave ndaj të pandehurës V. F., kolegji prej tre gjyqtarësh të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës më 22 dhjetor 2010 kishte vendosur të kthente edhe një herë pikën 2 të aktakuzës, përderisa kishte refuzuar ankesën e prokurorit lidhur me largimin e pikës 1 të aktakuzës ndaj të pandehurit V. F.

Shqyrtimi gjyqësor kishte filluar me tre seanca të mbajtura më 8 qershor, 5 dhe 6 korrik 2011, kur ishte bërë shpallja verbale e aktgjykimit të kundërshtuar.

Gjykata e Qarkut kishte dëgjuar të pandehurit A. A. dhe V. F. si dhe dëshmitarët F. T., X. P., A. V., I. S. dhe S. D.

Për më tepër, provat në vazhdim janë dorëzuar dhe janë vlerësuar nga kolegji i gjykatës: raporti i ekspertit financiar F. T., i datës 4 nëntor 2008; kontrata e punës e N.G., e datës 8 janar 2007; marrëveshja shtesë për punëtorin B. Z., e datës 10 janar 2007; Rregullorja e punëtorëve të aeroportit, e datës 28 qershor 2007; politikat e punës për Sh. A. Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, qershor 2005; Matrica e autorizimeve të Bordit të drejtorëve të aeroportit, e datës 6 qershor 2007; Memorandumi nga J.J., i datës 11 janar 2007; organogrami i strukturës organizative të aeroportit ndërkombëtar të Prishtinës, i datës 10 tetor 2007; shkallët dhe udhëzimet për page të Sh. A. Aeroporti ndërkombëtar i Prishtinës; memorandumi për A. A., i datës 2 nëntor 2007; Kontrata e punës për A. A., e datës 31 janar 2007; Memorandumi lidhur me Raportin e vlerësimit të ECAA, i datës 23 janar 2008; Përmbledhja e buxhetit të punës së Sh. A. Aeroporti ndërkombëtar i Prishtinës për vitin 2008; Aktet nënligjore të aeroportit ndërkombëtar të Prishtinës; fletëpagesa të ndryshme për furnizimin me karburante nga kompania Petrol Company dhe autorizimet për pagesën e këtyre karburanteve; numri i dokumentit të protokollit 022, i datës 9 prill 2008, i përgatitur nga A.V.A.; dokumentet e pagës për M. K., N. K., F. G., N. G., B. M. dhe për X. P.; shpallja e konkurseve të botuar nga gazeta Koha Ditore; procesverbali i panelit intervistues për pozitën e Zyrtarit të Administratës; Kontrata e punësimit për V. G., e datës 09 janar 2008 dhe shpallja e pozitës së tij e botuar në Kohën Ditore.

Më 06 korrik 2011, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor dhe para argumenteve përfundimtare, prokurori e ndryshoi aktakuzën dhe në veçanti i tërhoqi pikat 4 dhe 5 të aktakuzës kundër të pandehurit A. A., lidhur me punësimin dhe ngritjen në detyrë të B. Z. dhe V. G.

Gjykata e Qarkut duke u bazuar në gjetjet e veta, më 07 korrik 2011, me aktgjykim shpalli të dy të pandehurit të pafajshëm për pikat e mbetura të aktakuzës të përmendura më lart.

Prokurori Publik i Qarkut në Prishtinë ushtroi ankesë më 29 gusht 2011 kundër aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut, duke pohuar dhe propozuar si më lart.

Avokatët mbrojtës të dy të pandehurve dhanë përgjigjet ndaj ankesës së Prokurorit Publik të Qarkut në Prishtinë, avokati mbrojtës i A. A. më 08 shtator 2011 dhe avokati mbrojtës i V. F. më 12 shtator 2011, dhe të dytë propozuan që ankesa e prokurorit publik të refuzohet si e pabazuar.

ZPSHK-ja, me përgjigjen e datës 16 dhjetor 2011 mbështet në tërësi ankesat e ushtruara nga Prokurorit Publik i Qarkut në Prishtinë dhe propozon të pranohet kjo ankesë.

Më 03 prill 2012, Gjykata Supreme e Kosovës mbajti një seancë në përputhje me nenin 410 të KPPK-së.

Përfaqësuesi i ZPSHK-së dhe mbrojtja i referohen propozimeve përkatëse të tyre të paraqitura më parë.

GJETJET E GJYKATËS

A. Vërtetimi i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike

Prokurorit Publik i Qarkut në Prishtinë në ankesën e tij kundërshton aktgjykimin e shkallës së parë përkitazi me të pandehurin A. A., duke pretenduar në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Ankesa në veçanti thekson se *“Gjetjet e gjykatës se nuk ekzistojnë prova për vërtetimin e gjendjes së fakteve lidhur me qëllimin për sigurimin e përfitimit të paligjshëm material nga i akuzuari në fjalë janë të drejta [por se] kjo gjendje nuk do të thotë se nuk ka pasur shpërdorim të pozitës zyrtare ose tejkalim të autorizimeve zyrtare në verimet e të akuzuarit ...”*. *“Figura konkrete e kësaj vepre penale [...sa i përket ...] qëllimit të sigurimit të përfitimit të paligjshëm material për veten ose për një person tjetër [...] përbëhet nga një element tjetër tjerët thelbësor konkret përkatësish shkaktimi i dëmit ndaj një personi tjetër [...]”*.

Sa i përket të pandehurës V. F., Prokurori Publik i Qarkut ka vënë në pah opinionin e vet që *“ekziston prova që dëshmon keqpërdorimin e pozitës zyrtare duke i mos përmbushur detyrat e saja zyrtare [...pasi që...] disa dërgesa të karburanteve nga furnitori [...] në mënyrë të qartë tregojnë sasi më të madhe të karburanteve se sa sasia reale e karburanteve të pranuar [...]”*. Prandaj, konsiderohet që e pandehura ka keqpërdorur pozitën e saj zyrtare *“duke mos i përmbushur obligimet e saj të punës [...]”*.

Gjykata Supreme e Kosovës gjen se pretendimet e Prokurorit janë pa merita prandaj janë edhe të pabazuara.

Neni 339, paragrafi 1 i KPK-së në mënyrë të qartë përcakton kërkesat e veprës përkatëse penale si:

Kriteri objektiv:

1. Kryerësi që ka cilësinë e “personit zyrtar”;
2. I cili “keqpërdor detyrat e tij/saj, tejkalon kufijtë e autorizimeve të tij/saj [...]”

Kriteri subjektiv:

3. dhe – duke pasur qëllim të rregullt lidhur me të gjitha elementet objektive të veprës penale siç përshkruhet në nenin 339 të KPK-së
4. vepron “me qëllim (special) për të arritur përfitim të paligjshëm material për veten ose personin tjetër ose organizatën afariste ose ti shkaktoj çfarëdo dëmi personit tjetër apo organizatës afariste”

me qëllim që ta bëj atë.

Sa i përket kriterit të nenit 339, paragrafit 1 të KPK-së, Gjykata Supreme nuk ka asnjë dyshim që i pandehuri A. A. si Drejtor Menaxhues në aeroport ka pasur cilësinë e “personit zyrtar” siç kërkohet nga Ligji. Megjithatë, mund të jetë lënë e hapur, nëse ai me vetëdije apo jo i ka tejkualuar apo “keqpërdorur” kompetencat e tij, kur i ka ngritur në pozitë disa anëtarë të stafit– padyshim në baza të përkohshme siç tashmë është vërtetuar nga Gjykata e Qarkut.

Referencë i është bërë asaj që tashmë është shtjelluar në drejtim të Aktvendimit të konfirmuar lidhur me qëllimin e nevojshëm të qenit “*dolus specialis*” dhe të asaj që tashmë Gjykata e Qarkut e ka vënë në pah lidhur me këtë.

Çështja vendimtare është se nëse i pandehuri me qëllim të përmbushjes së kriterit objektiv siç kërkohet nga neni 339, paragrafi 1 i KPK-së, veç kësaj ka vepruar “me qëllim të arrij përfitim të paligjshëm material”. Siç tashmë gjyqtari për konfirmim ka vënë në pah, kërkesa i referohet “*dolus specialis*” veç kësaj qëllimit të rregullt që nevojitet për secilën vepër penale që nuk është e bazuar vetëm në neglizhencë. Elementi i referohet kërkesave subjektive të dispozitës, e cila nuk mund të zëvendësohet me kriter objektiv, siç është keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo tejkualimi i autorizimeve zyrtare në veprimet e të akuzuarit.

Gjithashtu “*elementi tjetër i rëndësishëm konkret domethënë që i shkakton dëme personit tjetër*” siç është theksuar nga Prokurori duhet të konsiderohet duke u bazuar në përmbajtjen e kërkuar, sepse kërkesa e Ligjit është – si alternativë në arritjen e përfitimeve materiale – qëllimi për ti shkakuar dëm personit tjetër etj. I fundit përsëri nuk është dëshmuar aspak nga Prokurori.

Gjykata e Qarkut tashmë ka vënë në pah që në të gjithat lëndët përkatëse ekzistojnë arsyet e mjaftueshme që – përkohësisht – ti paguhen të ardhura shtesë punonjësve përkatës, për shkak të sfidave të veçanta që ata u përballnin në kohërat e diskutueshme. Pasi që, gjithashtu vendimet “e ngritjes në pozitë” të pandehurit kanë bërë referencë

vetëm në pozitat e përkohshme, kjo nevojitet të interpretohet të jetë vetëm një vendim i përkohshëm deri sa të shpallet publikisht konkursi i duhur për punë.

Referencë i është bërë lëndës R. et al., ku është vendosur dhe vazhdimisht është referuar në shumë lëndë tjera më pas që vlerësimet e gjykatës së shkallës së parë nuk do të zëvendësohen nga Gjykata Supreme, nëse ato nuk konsiderohen që janë ‘tërësisht të gabueshme’.

Sa i përket të pandehurës V. F., referencë i është bërë asaj që gjykata e shkallës së parë tashmë e ka vërtetuar. Gjithashtu, këtu elementi i “*qëllimit të arrij përfitim të paligjshëm material*” nuk është dëshmuar. Siç gjithashtu është vërtetuar nga Gjykata e Qarkut, i pandehuri duke aprovuar faturat e karburanteve të dorëzuar asaj ka vepruar me qëllim të mbajtjes së punës së rregullt të aeroportit, kështu duke u mbështetur në korrektësinë e faturave të dorëzuara të karburanteve. Kjo gjithashtu është theksuar nga eksperti financiar z. S.T. që “zyra e prokurimit e ka bërë detyrën e saj” dhe që “zyra e prokurimit nuk ka asnjë përgjegjësi, çfarëdo qoftë ajo; kjo bie në zyrën financiare” (*aktgjykimi i atakuar, fq.8 i versionit në gjuhën angleze*).

B. Shkelje substanciale e Ligjit Penal

Sipas prokurorit, pasoja e përcaktimit të pretenduar të gabuar të gjendjes faktike e gjithashtu të shkeljes së Ligjit Penal, pasi që të pandehurit nuk janë shpallur fajtor.

Referencë i është bërë asaj që është vërtetuar më parë nën pikën A të këtij aktgjykimi. Si pasojë, asnjë shkelje e Ligjit penal nuk mund të vërtetohet.

Veç kësaj, referencë i është bërë neneve 90 dhe 91 të KPK-së dhe çështjes nëse lëndët apo jo, së paku veprat e pretenduara përkatëse penale që janë finalizuar para vitit 2007, kanë tejkaluar afatet kohore të parashkrimit në pajtim me nenin 90, paragrafin 1, pikat 5 (për akuzat kundër V. F. sipas pikës së akuzës 2 të aktakuzës) dhe 6 (për akuzat kundër A. A. sipas pikave të akuzës 2 dhe 3 të aktakuzës) të KPK-së. Pavarësisht nga çështja nëse parashkrimi nuk është ndërprerë nga aktivitetet e Prokurorit në pajtim me nenin 91, paragrafin 3 të KPK-së, për akuzat kundër A. A. në pajtim me pikat e akuzës 2 dhe 3 të aktakuzës kufiri për ndalesë absolute për përndjekjen penale ka kaluar sipas nenit 91, paragrafit 6. Për akuzat kundër V. F. ndalesa absolute për përndjekjen penale mundet të paraqitet vetëm në fund të vitit 2012.

Megjithatë, çështja e parashkrimit nuk duhet të vendoset në lëndën në fjalë duke marr parasysh që lirimet e Gjykatës së Qarkut janë vërtetuar.

Për arsye të lartpërmendura Gjykata Supreme ka vendosur si në dispozitiv.

Anëtar i kolegjit

Salih Toplica

Kryetar i kolegjit

Gerrit-Marc Sprenger

Anëtare e kolegjit

Marije Ademi

Procesmbajtës

Holger Engelmann

**Gjykata Supreme e Kosovës
AP.-KŽ. nr. 467/2011
Prishtinë
03 prill 2012**